



Islamic Relief Worlwid



Komuna e Vushtrrisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office dhe Komuna e Vushtrrisë hapë thirrje për aplikim për projektin **“Mbështetje e qëndrueshme e jetesës për familjet me jetimë dhe në nevojë, përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti”**

Nga ky projekt përfitojnë :

- 35 familje nga nje lopë ,
- 135 familje nga 50 pula (në përbërje 47 pula dhe 3 gjela për familje),
- 3 familje me dele (në përbërje 48 dele dhe 2 desh),
- 16 familje (sera),

Duke qenë se projekti në fjalë për objektiv ka fuqizimin e familjeve të varfëra rurale, (familjet me vështirësi ekonomike nga zonat rurale), inkurajojmë të aplikojnë familjet që janë në skemën sociale dhe që kanë vullnetin për të dalë nga skema sociale nga zhvillimi bujqësor i fermave të tyre.

Meqë numri i përfituesve është i kufizuar, vizitat dhe vlerësimet ne poentimin e familjeve ,do të bëhet nga komisioni i përbashkët ndërmjet Shoqatës Islamike Relievi dhe Komunës së Vushtrrisë i cili është përbërë nga 5 persona.

Ftohen të gjithë të interesuarit të aplikojnë për mbështetje përmes këtij projekti, ku përfitues do të jenë të gjithë familjet që i plotësojnë kriteret e parapara ne Thirrje për Aplikim.

Kriteret e veçanta për aplikim

- 1. Te jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë**
- 2. Aplikuesi duhet të ketë tokë në emër të vet (familjes) dhe atë për :

a) Lopë min 0.50 ha
b) Dele min 3.00 ha
c) Pula min 0.10 ha
d) Serra min 0.10 ha**
- 3. Aplikuesit duhet të jenë nga fshatrat e Komunës së Vushtrrisë**
- 4. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë personat fizikë me moshë nga 18 deri në 60 vjetë.**
- 5. Aplikuesit që kanë përfituar në tre vitet e fundit nga donacionet e Komunës së Vushtrrisë, do të refuzohen.**

Dokumentet për aplikim

- 1. Aplikacioni i plotësuar**
- 2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit**
- 3. Kopja e kartonit të ndihmave për rastet sociale**
- 4. Vërtetimi se e ka përmbush obligimin e tatimit në pronë dhe mbeturina.**
- 5. Certifikatë e vdekjes se prindit (Vlejnë vetëm për familjet me jetim)**
- 6. Dëshmi mbi posedimin e tokës bujqësore, toka duhet të jetë e aplikuesit (familje)**

Kriteret e poentimit në përzgjedhjen e aplikuesve

Gjatë poentimi, përparësi do u epët këtyre kategorive :

Kategoritë e familjeve jetim,

Kategoritë e grave vetë ushqyese,

Familjeve të skemës sociale,

Familjet me distancë të largët nga qendra e qytetit (viseve malore),

Familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara,

Familjet me numër më të madh të anëtarëve (numër të madh të anëtarëve të papunë)

Familjet me jetim	10 pikë			
Gratë vetë ushqyese	5 pikë			
Familjet e skemës sociale dhe familjet me aftësi të kufizuara	5 pikë			
Largësia nga qendra e qytetit	1-7 km (1 pikë)	8-10 km (2 pikë)	11-15 km (3 pikë)	Mbi 15 km (5 pikë)
Familjet me numër të papunëve	1-2 pa unë (1 pikë)	3-4 pa punë (2 pikë)	5- 6 pa punë (3 pikë)	7 e më tepër të papunë (5 pikë)
Numri i fëmijëve në familje	1-2 fëmijë (1 pikë)	3-4 fëmijë (3 pikë)	5 fëmijë (4 pikë)	6 e më tepër (5 pikë)
Kapaciteti i aplikuesit për jetësimin e donacionit (vlerësimi nga terreni)	1-15 pikë	Vërejtje : Vlerësimi real i gjendjes në terren, garanton suksesin e projektit		
Numri total i pikëve	50 pike			

Vërejtje: Përfituesit janë të obliguar para nënshkrimit të kontratës si përfitues të participojnë shumën **20%** të vlerës së përfituar .Informata dhe formulari i pagesës merret në DEBPZHR.

Afati për aplikim është nga data 20.02.2020 deri me 06.03.2020.

Drejtori I DEBPZHR-se : Miran Halili _____